

20251423152

Në bazë të nenit 52 paragrafit (3) të Ligjit për Arsimin Fillor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 161/19, 229/20, 3/25 dhe 74/25), ministri i Arsimit dhe Shkencës solli

**KALENDAR PËR ORGANIZIMIN DHE PUNËN E SHKOLLAVE FILLORE NË VITIN
SHKOLLOR 2025/2026**

Neni 1

Me këtë kalendar përcaktohet organizimi i vitit shkollor në shkollat fillore, konform njësive programore në vitin mësimor: gjysëmvjetori, format e tjera të aktivitetit edukativo-arsimor dhe pushimet e nxënësve për vitin shkollor 2025/2026.

Neni 2

Viti shkollor në shkollat fillore fillon më 1 shtator 2025 dhe përfundon më 31 gusht 2026.
Viti mësimor fillon më 1 shtator 2025 dhe përfundon më 10 qershor 2026.

Neni 3

Viti mësimor përbëhet nga dy gjysëmvjetore - gjysëmvjetori - I dhe gjysëmvjetori II.
Gjysëmvjetori i parë fillon më 1 shtator 2025 dhe përfundon më 30 dhjetor 2025
Gjysëmvjetori i dytë fillon më 20 janar 2026 dhe përfundon më 10 qershor 2026.

Neni 4

Gjatë vitit shkollor, nxënësit shfrytëzojnë pushimin dimëror dhe veror.
Pushimi dimëror fillon më 31 dhjetor 2025 dhe përfundon më 19 janar 2026.
Gjatë pushimit dimëror, të punësuarit në shkollë, nga 2 janar 2026 deri më 10 janar 2026, shfrytëzojnë ditë pune të paguara.
Pushimi veror fillojnë më 11 qershor 2026 dhe mbarojnë më 31 gusht 2026.

Neni 5

Shkollat fillore prej më 11 qershor deri më 19 qershor 2026, organizojnë mësim shtesë, provime përmirësuese dhe provime klasore, ndërsa prej më 17 gusht deri më 21 gusht 2026, organizojnë mësim përgatitor, konsultime dhe forma të tjera ndihme për nxënësit që duhet t'i nënshtrohen provimeve përmirësuese dhe provime klasore dhe t'i zbatojnë të njëjtit.

Neni 6

Veprimtaria edukativo-arsimore për nxënësit organizohet gjatë gjithë vitit të punës.

Neni 7

Në vitin shkollor 2025/2026, mësimdhënia realizohet në 180 ditë mësimore.

Neni 8

Në ditën e shkollës, organizohen manafestime kulturore, sportive dhe të tjera. Dita tradicionale e arsimit për anëtarët e bashkësive të cilat ndjekin mësim në gjuhë të ndryshëm nga gjuha maqedonase shënohet me manafestime kulturore dhe të tjera. Dita e shkollës dhe dita tradicionale e arsimit për anëtarët e bashkësive të cilat ndjekin mësimin në gjuhë të ndryshme nga gjuha maqedonase, janë ditët mësimore kur realizohen programe të veçanta për manifestimet nga paragrafi 1 dhe 2 të këtij neni.

Neni 9

Ditët e punës kur realizohen ekskursionet e nxënësve, dita e shkollës dhe dita tradicional e arsimit për anëtarët e bashkësive të cilat ndjekin mësimet në gjuhë të ndryshme nga gjuha maqedonase, janë ditët mësimore kur realizohen programet e veçanta. Për nxënësit të cilët nuk i vizitojnë ekskursionet e nxënësve, shkolla organizon mësimet të rregullta konform orarit të orëve mësimore.

Neni 10

Me ditën e fillimit të zbatimit të këtij kalendari, pushon së vlefshmi Kalendari për organizimin e punës së shkollave fillore në vitin shkollor 2024/2025 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 164/24 dhe 180/24).

Neni 11

Ky kalendar hyn në fuqi ditën e nesërme pas ditës së publikimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" ndërsa do të filloj të zbatohet prej më 1 shtator 2025.

Nr. 12-9053/3
11.7.2025
Shkup

Ministre e Arsimit
dhe Shkencës,
проф. д-р **Весна Јаневска**, с.р.